



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



04/ Nr/ 5612 /2026

**PROCESVERBAL I DËGJIMIT BUXHETOR
NË LIDHJE ME KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE
(KAB) 2027-2029 – Hani i Elezit**

Procesverbali nga dëgjimi i parë buxhetor në lidhje me Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027 - 2029 u zhvillua me datën **02.06.2026** duke filluar nga ora 10:30 në Sallën e Takimeve, Objekti i Komunës në Han të Elezit, në të cilin ishin gjithsej 20 pjesëmarrës, prej të cilëve 11 ishin gra dhe 9 burra.

Dëgjimin buxhetor e kryesoi Kryetari i Komunës z.Mehmet Ballazhi i cili i përshëndeti të pranishmit dhe i falënderoi për pjesëmarrjen e tyre, ndërkaq morën pjesë edhe drejtor e drejtoreshë nga ekzekutivi i Komunës, ku për rend të ditës kishin:

1. Prezentimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027-2029

2. Diskutimi i hapur

Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027-2029 e prezantoi Drejtorja për Buxhet dhe Financa, **znj.Lindita Ballazhi**.

1. Prezentimi i Draft Kornizës Afatmesme Buxhetore

Lindita Ballazhi: Duke u bazuar në Ligjin për Financa Publike dhe Përgjegjësitë, Qeveria e Kosovës gjatë muajit maj të këtij viti ka aprovuar Kornizën Afatmesme të shpenzimeve qeveritare apo KASH-in për periudhën 2027-2029, ku në bazë të Kornizës Afatmesme Buxhetore të shpenzimeve qeveritare lëshoet Qarkorja e parë buxhetore dhe me kufijtë fillestarë në nivel të Kosovës. Me pranimin e Qarkores së parë buxhetore, kemi kufijtë fillestarë buxhetore me të cilat ne bëjmë planifikimin e buxhetit për vitin vijues apo konkretisht për vitin 2027, si dhe parashikimet e hershme për vitin 2028-2029, me ç'rast ne bëjmë hartimin e shpenzimeve duke renditur prioritetet kryesore komunale dhe normalisht objektivat të cilat janë të identifikuar në dokumente strategjike komunale. Fazat për zhvillimin e KAB-it komunal dhe afatet kohore janë: në maj Pranimi i Qarkores fillestare Buxhetore 01/2027, Draftimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027-2029, në

qershor Konsultimet me Asamblenë Komunale, Mbajtja e Debateve Buxhetore dhe Aprovimi i KAB-it në KPF dhe Kuvend Komunal deri me 30 qershor.

Për vitin buxhetor 2027 Buxheti i Komunës do të jetë 4,564,793.00 €, Ndërkaq tani presim projekt propozimet tuaja për vitin buxhetor 2027.

2. Diskutimi i hapur

Vjosa Livoreka – Dëshiroja ta bëj një pyetje, te kjo pjesa e qytetit ku është duke u ndërtu uji, ka prishje të asfaltit nëpër qytet, a planifikohet më 2027 të rregullohet apo brenda këtij viti?

Mehmet Ballazhi thekson: E kemi diskutuar edhe me Drejtorin e Urbanizmit, duke qenë se edhe e kemi pasur një kërkesë për ri-asfaltim të asaj zone, por mbasi e kemi projektin e Sheshit të qytetit, kemi me pas edhe dëmtime tjera kur të punohet, andaj për asfaltimin e asaj rruge planifikohet në vitet vijuese.

Betime Dernjani – E kam një propozim nëse janë mundësitë me u ndërtu një kënd i lodrave në SHFMU “Kështjella e Diturisë” në fshatin Paldenicë?

Mehmet Ballazhi thekson: E di që ka lodra, por nuk janë mjaftueshëm. Kam diskutuar me SharrCem, në Shkollën që do të ndërtohet në Lagjen e Re do të ndërtohet edhe këndi i lodrave por gjithashtu edhe në shkollat tjera ku ka nevojë, në Gorancë, Paldenicë etj.

Lindita Ballazhi: Ne kemi mbajtur procesverbal të këtij debati dhe të gjitha propozime tuaja do të shqyrtohen sërish. Nëse dikush ka ndonjë pyetje tjetër apo propozim, mundeni edhe të më drejtorheni në emailin tim Lindita.ballazhi@rks-gov.net apo edhe kërkesat tuaja ti dërgoni fizikisht tek Qendra për Shërbim me Qytetarë, e më pas ne do t'i shqyrtojmë të gjitha kërkesat, sugjerimet, rekomandimet dhe propozimet tuaja, si ato gjatë këtij dëgjimi, ashtu edhe ato përmes emailit dhe përmes dërgimit të QSHQ. Nëse nuk ka tjetër diskutim apo propozim, e konsideroj të mbyllur dëgjimin buxhetor.

Debati publik përfundoi në orën 11:15.

Procesmbajtësja
Lindita Ballazhi

